



## Trajnim për Auditor të Brendshëm, SHKURT 2019

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës njofton se trajnimi për Auditor të Brendshëm planifikohet të fillojë në Shkurt 2019. Trajnimi do të mbahet në Prishtinë me tre lëndët e parapara për këtë nivel:

- B1/Elementet e njohurive të Auditimit të Brendshëm
- B2/Bazat e Auditimit të Brendshëm
- B3/Praktika e Auditimit të Brendshëm

Të interesuarit mund të aplikojnë **prej datës 01 nëntor deri më 31 dhjetor, 2018**, gjatë ditëve të punës prej orës 9.00 - 12.00 dhe 14.00 – 16.30, në zyrën e SHKÇAK, Prishtinë (Rr. Sylejman Vokshi nr.50).


Aplikacioni për regjistrim si dhe të gjitha informatat e domosdoshme për aplikim mund të merren edhe në Zyrën Ekzekutive të Shoqatës.

Pagesat:

- Aplikimi EUR 20
- Trajnimi dhe libri për një lëndë EUR 250
- Provimi për një lëndë EUR 50
- Pagesa e anëtarësisë vjetore si student EUR 60

Pagesa bëhet në llogaritë bankare të SHKÇAK:

- Banka për Biznes - BpB  
Nr: 1300271200089555 për NGO SCAAK/SHKÇAK
- Pro Credit Bank  
Nr: 1110161271000192



ShKÇAK  
DKRRK  
SCAAK

# PROGRAMI PËR ÇERTIFIKIM TË AUDITORËVE TË BRENDSHËM

(auditor i brendshëm i certifikuar - ABC / CIA)

## Hyrje

Programi i çertifikimit në Auditim të Brendshëm është krijuar ngase auditimi i brendshëm është shtyllë kryesore e qeverisjes së mirë duke ofruar të gjithë akterëve një perspektivë të pavarur mbi menaxhimin e entitetit, qoftë biznes privat apo institucion publik, si dhe ndihmon në identifikimin e problemeve dhe nevojave për përmirësim.

Auditor i Brendshëm është ai person eksperiencia dhe kualifikimi profesional i të cilit e ka kualifikuar mbajtësin e titullit për të u emëruar për kryerjen e një game të gjerë të aktiviteteve, përfshirë këtu vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm, analizën e informacioneve financiare dhe jo financiare, kontrollimin e aktiviteteve operacionale, zbulimin e gabimeve të mundshme brenda entitetit dhe gjithashtu ofrimin e sugjerimeve të nevojshme për përmirësime.

Raporti i auditorit të brendshëm jo domosdoshmërisht raporton për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë, por fokusohet në rreziqet kyçe me të cilat përballet biznesi dhe nëse biznesi i menaxhon ato rreziqe në mënyrë efektive.

### 1. Edukimi profesional dhe provimet

Programi i çertifikimit për Auditor të Brendshëm, si të sektorit publik ashtu edhe atij privat, është i bazuar në plan programin e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA, me bazë në Amerikë) si dhe me materiale e literaturë të Wiley, botuesit të aprovuar nga IIA.

Ky program çertifikues është i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) i Kosovës dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare të edukimit dhe trajnimit si dhe standardet profesionale të Auditimit të Brendshëm.

Çertifikimit për Auditor të Brendshëm përfshin tre lëndë, ku lënda e parë përmban tema të përgjithshme nga fusha të ndryshme të cilat janë të nevojshme për një auditor të brendshëm. Lëndët dy dhe tre janë ekskluzivisht të përqendruara në punën e auditorit të brendshëm dhe zbatimin adekuat të standardeve të auditimit të brendshëm.

<b>Auditor i Brendshëm</b>
B1/Elementet e njohurive nga Auditimi i Brendshëm
B2/Bazat e Auditimit të Brendshëm
B3/Praktika e Auditimit të Brendshëm

### 2. Kush mund të regjistrohet për specializim si Auditor i Brendshëm

Ky kualifikim është i hapur për gjeneratat e reja të studentëve dhe anëtarët e Shoqatës të cilës pas përfundimit të provimeve të parapara në këtë skemë si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante do të përfitojnë thirrjen përkatëse.

**Gjeneratat e reja të studentëve** mund të orientohen për specializim në këtë fushë pa ndjekur trajnimin “Teknik Kontabiliteti”. Kandidati i cili përfundon me sukses të tre lëndët dhe përbushë kërkesat e përvojës praktike relevante, fiton titullin “Auditor i Brendshëm”.

**Anëtarët e ShKÇAK të cilët kanë fituar thirrjen “Teknik Kontabiliteti”** do të mund të ndjekin edhe këtë specializim dhe kushtet janë të njëjta si më lart, pra duhet përfunduar tre lëndët e programit dhe të përbushin kërkesat e përvojës praktike relevante.

Ndërkaq, **anëtarët të cilët kanë thirrjen “Kontabilist i Çertifikuar”, “Auditor i Çertifikuar”** në sektorin privat dhe **“Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik”** do të mund të ndjekin këtë specializim dhe të fitojnë thirrjen “Auditor i Brendshëm” pas përfundimit të lëndëve dy dhe tre si dhe përbushjes së kërkesave të përvojës praktike relevante.

Ky kualifikim është i domosdoshëm për të gjithë personat që dëshirojnë karrierë qoftë në sektorin privat apo publik duke u fokusuar në vlerësimin e sistemeve të brendshme, qeverisjes së mirë dhe ofrimin e sugjerimeve për përmirësim.

### **3. Kërkesat për ta fituar thirrjen ‘Auditor i Brendshëm i Certifikuar’**

- *Edukimi universitar:* kandidatët duhet të kenë të kryer së paku një fakultet të nivelit baqelor.
- *Edukimi profesional:* kandidatët duhet të ketë ndjekur trajnimin profesional të këtij programi dhe duhet të kenë kryer të gjitha provimet e parapara.
- *Përvoja praktike:* kandidatët duhet të kenë së paku 24 muaj eksperiencë në menaxhment, auditim të brendshëm ose në ndonjë pozitë ekuivalente. Përvoja praktike mund të realizohet para ose pas regjistrimit në programin certifikues por thirrja mund të fitohet vetëm pas arritjes së të gjitha kërkesave të programi certifikues.
- *Kodi i etikës:* kandidatët duhet të respektojnë kërkesat e Kodit të Etikës të Institutit të Auditorëve të Brendshëm (The IIA).

### **4. Kërkesat për edukim të vazhdueshëm profesional (EVP)**

Pas marrjes së thirrjes **‘Auditor i Brendshëm i Çertifikuar’** kandidatët të cilët *vazhdojnë ta ushtrojnë profesionin e auditimit të brendshëm* duhet të dëshmojnë kryerjen e 24 orë-ve të verifikueshme të edukimit të vazhdueshëm çdo vit në mënyrë që ta mirëmbajnë thirrjen e fituar.

Kandidatët të cilët *e kanë fituar thirrjen por që nuk vazhdojnë ta ushtrojnë profesionin e auditimit të brendshëm*, për ta mbajtur këtë thirrje, duhet të dëshmojnë kryerjen e 12 orë-ve të edukimit të vazhdueshëm çdo vit. Kjo kategori e anëtarëve, mund ta mbajë thirrjen aktive, mirëpo nuk mund të praktikoj auditimin e brendshëm.

Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë orët e lartcekura të EVP-së nuk do ta mbajnë thirrjen ‘Auditor i Brendshëm i Çertifikuar’ dhe do të klasifikohen si jo-aktiv, derisa të dëshmojnë kryerjen e orëve minimale të EVP-së sipas kategorive të anëtarëve aktiv të listuar më lartë.

Temat e përgjithshme të cilat janë të pranueshme për qëllime të EVP-së duhet të jenë nga këto fusha: (i) kontabilitet dhe auditim; (ii) menaxhment dhe komunikim; (iii) shkencat kompjuterike; (iv) matematika, statistika dhe aplikimet kuantitative në biznes; (v) ekonomi; (vi) ligjet biznesore, (vii) tema specifike të biznesit si: financat, prodhimi, marketingu, resurset humane; (viii) industrinë e specifikuar si; sektori publik, bankar, i sigurimeve, mikrofinanciar, ndërtimtarisë, etj.

EVP-të mund të mbahen në shoqatat profesionale të cilat janë anëtare të FNK-së, apo në shoqatat/organizatat të cilat janë të autorizuar në atë shtet të ofrojnë EVP. Kandidatët duhet të sjellin çertifikatën e pjesëmarrjes për secilën orë të EVP-së të cilën e kanë mbajtur.

## 5. Tarifat për trajnime, provime, anëtarësi dhe EVP

- Regjistrimi për herë të parë në Shoqatë është 20€.
- Pagesa për pjesëmarrje në ligjëratë e cila përfshinë librin dhe trajnimin është 250€.
- Pagesa për provim është 50€.
- Tarifa e anëtarësisë **para** marrjes së titullit Auditor i Çertifikuar i Brendshëm është 60€/vit (niveli student).
- Tarifa e anëtarësisë **pas** marrjes së titullit Auditor i Çertifikuar i Brendshëm është 144€/vit.
- Tarifa e certifikatës është 30€.
- Tarifa për anëtarët aktiv për EVP-të e organizuara nga ShKÇAK është 7.5€/orë.

## 6. Ligjërimi, përgatitja, kontrollimi dhe publikimi i rezultateve të provimeve

Ligjëruesit, përgatitja e provimeve, kontrollimi i tyre si dhe publikimi i rezultateve do të realizohen në pajtueshmëri me procedurat e brendshme të aprovuara të ShKÇAK të cilat do të sigurojnë arritjen e rezultateve cilësore në ofrimin e këtij programi.

- Si parakusht për t'iu nënshtruar provimit është pjesëmarrja në ligjëratë.
- Kalueshmëria e provimit është 50 pikë e lartë.

## 7. Kontrolli i cilësisë së auditorëve të brendshëm

Në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm Nr. 1300 – ‘*Programi i Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë*’, vlerësimi i jashtëm i kontrollit të cilësisë duhet të bëhet së paku një herë në pesë vite. Vlerësimi i jashtëm duhet të bëhet nga një vlerësues i pavarur dhe i kualifikuar ose nga një ekip vlerësimi.

Së paku një herë në pesë vite anëtari i ShKÇAK i cili mbanë thirrjen Auditor i Brendshëm i Certifikuar dhe i cili e praktikon profesionin e auditimit të brendshëm, duhet të sjellë një kopje të raportit të vlerësimit, si një nga kushtet për vazhdimin e anëtarësisë.



**Formular i regjistrimit**  
**Auditori i Brendshëm i Çertifikuar**

Ju lutemi plotësoni formularin me shkronja të shtypit

Numri personal

A është hera e parë që aplikoni në ShKÇAK?

PO  JO

**Informata të përgjithshme**

Emri

Emri i prindit

Mbiemri

Data e lindjes

Gjinia

Adresa

Komuna

Numri i telefonit privat dhe mobil

Numri i telefonit zyrtar

E-mail adresa

Niveli i shkollimit

I punësuar në

Pozita aktuale



Akademi/Edukim

Firma të Kontabilitetit/Auditimit

Studentë

Banka

Institucionet shtetërore të R. Kosovës

OJQ

Institucione mikrofinanciare

Kuvendet Komunale të R. Kosovës

Institucione ndërkombëtare

Kompani e sigurimeve

Parlament/Presidencë

Institucionet e pavarura publike

Industri/Tregti

Ndërmarrje publike

Tjera

Ju lutemi specifikoni

Shënoni gjuhët të cilat i flisni dhe nivelin

Gjuha

Lexon

Flet

Shkruan

Udhëzimet: 5 - Gjuhë antare, 4 - Shkëlqyeshëm, 3 - Shumë Mirë, 2 - Mirë, 1 - Dobët

Shënimet mbi shkollimin

Prej

Deri

Shkolla/Institucioni

Vendi

Përvoja e punës

Prej

Deri

Organizata

Pozita



## Formular i regjistrimit

Ju lutemi plotësoni formularin me shkronja të shtypit

### Kërkoj lirim nga provimet e mëposhtme

- B1/Elementet e njohurive nga Auditimi i Brendshëm
- B2/Bazat e Auditimit të Brendshëm
- B3/Praktika e Auditimit të Brendshëm

### Vetëm për ShKÇAK (Provimet e liruara nga SHKÇAK)

- B1/Elementet e njohurive nga Auditimi i Brendshëm
- B2/Bazat e Auditimit të Brendshëm
- B3/Praktika e Auditimit të Brendshëm

### Vetëm për ShKÇAK (Provimet e liruara nga SHKÇAK)

Provimet e shënuara me X në pjesën për ShKÇAK janë aprovuar:

Po  Jo

Aprovuar nga

Data e provimit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

17:30-20:30

Të shtunave 9:00-13:00 ose 14:00-18:00

ShKÇAK mbanë të drejtën për ndërrimin e orarit

Nënshkrimi i aplikuesit

Data e aplikimit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Numri i ID-së

Grupi

E aprovuar

Data e aprovimit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



**Formular i regjistrimit**  
**Auditori i Brendshëm i Certifikuar**

Ju lutemi plotësoni formularin me shkronja të shtypit

Të nderuar studentë, luteni që t'i lexoni me kujdes: Statutin e Shoqatës dhe Kodin Etikës. ShKÇAK ka adoptuar Kodin Etik të Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IAB / IIA) çka nënkupton obligimin e respektimit dhe të sjelljes së anëtarëve në përputhje me dispozitat e këtij kodi si dhe disa nga rregullat kryesore të ShKÇAK të cekura në vijim, para se të nënshkruani që pajtoheni me to.

- Aplikuesi për pranim në anëtarësi duhet t'i plotësoj kërkesat për edukim, përvojë praktike, provime dhe kërkesa tjera të cekura në udhëzuesin e ShKÇAK.
- Anëtarët studentë nuk do të kenë të drejtë vote në punën e Asamblesë.
- Kryerja e pagesës vjetore të anëtarësisë të miratuar nga Asambleja dhe të implementuara sipas Urdhresës Administrative të Këshillit të ShKÇAK janë obligative në mënyrë që të merrni çfarëdo shërbimi nga ShKÇAK (p.sh. pjesëmarrja në provime dhe trajnime, vërtetime të çfarëdo lloji, pjesëmarrje në seminare, etj)
- Pagesat për anëtarësim gjatë procesit të Çertifikimit janë:

Anëtarësia për student: EUR 60 / vit

Anëtarësia për Auditor të Brendshëm të Çertifikuar: EUR 144 / vit

- Nëse për një periudhë prej minimum 24 muaj nuk e keni paguar anëtarësinë dhe gjatë së cilës kohë nuk keni ushtruar asnjë aktivitet në lidhje me SHKÇAK, por jeni të interesuar të vazhdoni me provime ju mund të riaktivizoheni duke e paguar anëtarësinë vjetore (vlen vetëm për studentë) si dhe shumën prej 50€ për riaktivizim.
- Studentët/anëtarët të cilët mendojnë se rezultati i provimit nuk reflekton përkushtimin e tyre në provim kanë mundësi të paraqesin kërkesë për rishikimin e provimit. Ky rishikim bëhet në mënyrë të pavarur nga komisioni i caktuar nga ShKÇAK. Në rishikim të provimit nuk lejohet prania e studentëve/anëtarëve.

• SHKÇAK ka rregulla strikte lidhur me mashtrimin dhe kopjimin. Këto rregulla janë paraparë dhe formuluar me qëllim të sigurimit që e tërë puna e studentëve/anëtarëve të vlerësohet si rezultat i përpjekjeve dhe mundit të tyre individual, aftësive dhe dijes së tyre dhe jo si rezultat i përparësive të padrejta ndaj studentëve të tjerë.

Mashtrimi është definuar si shfrytëzim i padrejtë i përparësive. Prandaj, çdo student i cili zbulohet të ketë përdorur mashtrimin, është përpjekur të bëjë mashtrim apo ka ndihmuar dikë të bëjë mashtrim do të jetë subjekt i procesit disiplinor sipas Procedurave Disiplinore të SHKÇAK.

• I përfshirë në procedurë disiplinore mund të jetë çdo anëtar apo student cili me veprimet e veta ka bërë shkelje të rregullave të mirësjelljes dhe të Kodit Etik.

• Asnjë dokument (formular, aplikacion, formë e kërkesës ose çfarëdo dokumenti tjetër) i SHKÇAK NUK mund të ndryshohet/përmirësohet ose azhurnohet për nevoja individuale të studentëve/anëtarëve. Çfarëdo kërkesë shtesë që kanë studentët/anëtarët, por për të cilën nuk ekziston formular i posaçëm i SHKÇAK, DUHET të bëhet me shkrim, të nënshkruhet dhe të dorëzohet në Administratën e SHKÇAK.

• Ndërrimi i adresës – Për çdo ndërrim të adresës (elektronike, vendbanimit) si dhe telefonit duhet ta lajmëroni Administratën e SHKÇAK. Ky lajmërim do të jetë në interesin tuaj duke pasur parasysh se në raste të ndryshme paraqitet nevoja që të kontaktoheni individualisht.

• Pagesat e kryera për aplikim, anëtarësi, ligjërata dhe provime nuk kthehen dhe destinimi i pagesës nuk mund të ndryshohet (p.sh. Pagesa e kryer për provimin B1 nuk mund të shfrytëzohet për provimin B2).

• Studentët obligohen që t'i vijojnë ligjëratat sipas orarit të grupit në të cilin janë përcaktuar nga SHKÇAK. Mungesa në ligjëratat nuk mund të kompensohet në afatet e ardhshme.

• Studentët janë të obliguar që për çfarëdo ndryshimi që dëshirojnë ta bëjnë të marrin aprovimin e Administratës.

• ShKÇAK shqyrton vetëm kërkesat e dërguara me shkrim, andaj kërkesat tuaja mund t'i dërgoni përmes adresës elektronike.

**Me nënshkrimin tim konfirmoj se i kam lexuar dhe kuptuar informatat dhe rregullat e mësipërme me të cilat pajtohem në tërësi dhe njëherit deklaroj se do ta rrespektoj Statutin e SHKÇAK, Kodin Etik dhe Rregullat e Mirësjelljes Profesionale.**

**Nënshkrimi i studentit** \_\_\_\_\_





---

Duke u mbështetur në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-172 Për mbrojtjen e të dhënave personale dakordohem që:

Unë, \_\_\_\_\_, me vetëdije të plotë jap pëlqimin tim për përpunimin e të dhënave të mija personale për qëllime të aplikimit për regjistrim dhe trajnim në Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës.

Data

Nënshkrimi